



REPUBLIKA E SHqipëRISE
MINISTRIA E FINANCAVE
DHE EKONOMISE

PLANIFIKIMI FINANCIAR AFATMESËM PËR NJËSITË E VETËQEVERISJES VENDORE NË KONTEKSTIN E SHQIPËRISË

MANUAL PËR INSTRUMENTIN E PLANIFIKIMIT FINANCIAR ME BAZË EXCEL



5

 Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra
Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC

dldp
decentralisation and local
development programme

 **HELVETAS**
ALBANIA

VERSION I DYTË
TETOR 2018

PLANIFIKIMI FINANCIAR AFATMESËM PËR NJËSITË E VETËQEVERISJES VENDORE NË KONTEKSTIN E SHQIPËRISË

**MANUAL PËR INSTRUMENTIN E PLANIFIKIMIT FINANCIAR
ME BAZË EXCEL, VERSION I DYTË**

Tetor 2018
Stefan PFÄFFLI, Alex LÖTSCHER, Sabina YMERI

**Publikuar nga Programi për Zhvillim Lokal dhe Decentralizim (dlDP),
financuar nga Qeveria Zvicerane përmes
Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC),
zbatuar nga Helvetas Swiss Intercooperation**

Përgatitur nga:

Sabina Ymeri - Istituti Studimeve Bashkëkohore
Prof. Stefan Pfaeffli & Alex Loetscher
University of Applied Sciences and Arts, Lucerne Business School, Switzerland

Mbështetur nga:

Valbona Karakaçi, Elvin Hoxha
Programi për Zhvillim Lokal dhe Decentralizim (dlDP)
HELVETAS Swiss Intercooperation, Albania

Ky publikim reflekton mendimet e autorëve dhe jo detyrimisht të SDC.

Publikuar nga:

**Programi për Zhvillim Lokal dhe Decentralizim (dlDP)
HELVETAS Swiss Intercooperation (HSI) Albania
Copyright © HSI Albania**

www.dldp.al

Të nderuar kolegë në qeverisjen vendore,

Manuali që po merrni sot në dorë është një dokument i rëndësishëm, i cili shpjegon në mënyrë të hollësishme Instrumentin e Planifikimit Financiar (IPF), duke ju ardhur në ndihmë gjatë punës suaj në hartimin e buxhetit të Bashkisë.

Me mbështetjen e Programit për Decentralizim dhe Zhvillim Vendor (dldp), i financuar nga Agjencia Zvicerane për Bashkëpunim dhe Zhvillim (SDC), kemi arritur të përmbyllim me sukses një proces të gjatë konsultimi e bashkëpunimi për konsolidimin e IPF dhe përfshirjen e këtij instrumenti në Udhëzimin Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për procedurat e hartimit të buxhetit afatmesëm të Bashkive.

Decentralizimi ka qenë dhe mbetet një nga sektorët e rëndësishëm të punës së qeverisë shqiptare, duke shënuar arritje të rëndësishme. Reforma Administrative Territoriale krijoi mundësi për fuqizimin e Bashkive dhe më shumë potenciale për zhvillim ekonomik e social. Ligji për vetqeverisjen vendore dhe Ligji për Financat vendore përbëjnë dy shtylla të rëndësishme të decentralizimit. Funkcionet e reja që iu kaluan qeverisjes vendore që prej fillimit të vitit 2016, treguan se pavarësisht sfidave, Bashkitë kanë bërë përpjekje të lavdërueshme për të përmirësuar shërbimet ndaj qytetarëve dhe komunitetit.

Gjithë ky kuadër reformash, kërkon nga ana tjetër, një përgjigje energjike me staf të kualifikuar dhe me dije në sektorë të ndryshëm të veprimtarisë së qeverisjes vendore. Pikërisht për këtë arsye, një rëndësi të veçantë merr edhe kuadri i ofrimit të njohurive, në mënyrë institucionale, cilësore dhe të qendrueshme. Ky manual, si dhe i gjithë kuadri i trainimit afatgjatë që i ofrohet nivelit vendor në menaxhimin e financave, krijon mundësitë për një zbatim më të mirë të njohurive në punën e përditshme, me synim rritjen e eficensës dhe efektivitetit të përdorimit të të ardhurave publike, por në rradhë të parë në përmirësimin e të gjithë punës dhe performancës së Bashkive kundrejt qytetarëve.

Edhe një herë, falenderojmë Qeverinë Zvicerane për ndihmën e dhënë dhe që vazhdon të japë në lidhje me modernizimin e financave vendore.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Tabela e lëndës

1.	Hyrje	9
2.	Kuadri i përgjithshëm dhe struktura e instrumentit	11
3.	Skedat input	12
3.1.	Titulli (A1)	12
3.2.	Informacion i përgjithshëm (B1)	12
3.3.	Organizata (B2)	13
3.4.	Struktura funksionale (B3)	14
3.5.	Shpenzimet e vitit të kaluar (C1)	16
3.6.	Investimet e vitit të kaluar (C1B)	17
3.7.	Burimet e vitit të kaluar (C2)	18
3.8.	Të prapambetura (C3)	20
3.9.	Të mbartura me destinacion (C4)	20
3.10.	Angazhimet (C5)	21
3.11.	Lista emërore e projekteve të investimeve	22
3.12.	Tavanet buxhetore (D1)	23
3.13.	Parashikimet makroekonomike (D2)	24
3.14.	Përlogaritja e të ardhurave: Vlerësimi i Burimeve Buxhetore (E1)	25
3.15.	Përlogaritja e burimeve: Taksat e ndara (E1)	27
3.16.	Përlogaritja e burimeve: E1: Tarifat	28
3.17.	Përlogaritja e burimeve: Të ardhura jotatimore (E1)	28
3.18.	Përlogaritja e të ardhurave nga buxheti i shtetit (transfertat) dhe huatë (E1)	29
3.19.	Formularët e kërkesës buxhetore FKB (FKB1 - FKB29)	29
4.	Të dhënat output dhe interpretimi i tyre (F1 - F16)	35
5.	Lista e termave teknikë dhe shkurtimeve	37

Figura

Figura 1: Skeda me ngjyra që përfaqësojnë klasa të ndryshme fletësh	9
Figura 2: B2 - Organizimi	14
Figura 3: B3- Struktura funksionale	15
Figure 4: C1 - Shpenzimet e vitit të kaluar	16
Figura 5. C1b Investimet: Vitet e kaluara dhe viti aktual	17
Figure 6: C2 - Burimet buxhetore të vitit të kaluar	19
Figura7 : C3 - Detyrimet e prapambetura	20
Figura 8: C4 - Trashëgimi me destinacion	21
Figura 9: C5 - Angazhimet	22
Figura 10: E3 - Lista emërore e projekteve të investimeve	23
Figura 11: D1 - Tavanet	24
Figura 12: D2 - Llogaritjet makroekonomike	25
Figura 13: E1 - Vlerësimi i burimeve buxhetore	26

Figura 15: E1- Tarifat e ndara	28
Figura 16: E4 – Të tjera	28
Figura 17: Përlllogaritja e të ardhurave nga buxheti I shtetit (transfertat) dhe huatë (E1)	29
Figura 18: FKB1 deri FKB27 – Formulari i kërkesës buxhetore	31
Figura 20: Përlllogaritja e të ardhurave brenda formularit të kërkesës buxhetore	33

Tabela

Tabela 1: Klasat e fletëve të punës dhe karakteri i tyre	9
Tabela 2: Treguesit financiarë	36

1. Hyrje

Prej vitit 2009, njësitë e vetëqeverisjes vendore në Shqipëri kanë detyrimin të përgatisin një buxhet afatmesëm të bazuar në ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar. Me buxhetin afatmesëm ligji kërkon një qasje dhe plan financiar të integruar për një kuadër kohor trevjeçar. Ligji nr. 68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” konfirmoi dhe specifikoi më tej këtë kërkesë ligjore. Buxheti afatmesëm është një hallkë ndërmjet planifikimit afatgjatë strategjik në një kuadër kohor dhjetëvjeçar ose më shumë si dhe buxhetit vjetor.

Tradicionalisht, buxhetet e njërive të qeverisjes së përgjithshme kanë patur një shtrirje vetëm njëvjeçare. Mangësia e buxheteve njëvjeçare është orientimi i tyre afatshkurtër. Zakonisht, në një afat të shkurtër, ka pak fleksibilitet buxhetor për shpërndarjen e burimeve në funksion të objektivave afatgjatë të zhvillimit strategjik. Për të pasur një planifikim të saktë të fondeve buxhetore, është futur orientimi i buxhetit afatmesëm si një plotësim i buxhetit vjetor. Nga viti 2009 janë bërë përpjekje të vazhdueshme për përfshirjen e njërive të vetëqeverisjes vendore në procesin e planifikimit buxhetor afatmesëm, edhe pse në disa raste ky proces ka dështuar për shkak se njësitë vendore nuk arritën të përshtateshin më ndryshimet në planifikimin buxhetor.

Planifikimi financiar për afate të shkurtra dhe të mesme u identifikua si një sfidë kryesore për qeverisjen vendore shqiptare. Për këtë arsye, nga viti 2010, projekti i decentralizimit dhe zhvillimit vendor, dldp, i financuar nga Swiss Agency for Development and Cooperation SDC dhe i zbatuar nga Helvetas Swiss Intercooperation, përpunoi idenë e lehtësimit të procesit të buxhetit afatmesëm nëpërmjet një instrumenti në Excel të planifikimit financiar (IPF). Instrumenti duhej të ishte me kosto të ulët, i përshtatshëm për kontekstin shqiptar dhe i zbatueshëm në çdo bashki të Shqipërisë. Veç këtyre, ai duhej të formulohej në përputhje me rekomandimet ndërkombëtare dhe kërkesat ligjore shqiptare për procesin e përgatitjes së buxhetit vjetor dhe afatmesëm. Mbështetësi i DLDP në Universitetin e Shkencave të Aplikuara dhe Arteve të Lucernës - HSLU – e promovoi me forcë këtë ide; ekspertët e HSLU dhanë mbështetje teknike dhe konceptuale në bashkëpunim me ekspertët lokalë të dlpd-së, ndërsa specialistët e Ministria e Financave dhe Ekonomisë siguruan përputhjen e saj në kontekstin shqiptar.

Dalja e parë e IPF u testua në terren nga ekspertët vendorë të DLDP-së në vjeshtë 2011 dhe pranverë 2012 në bashkëpunim të ngushtë me ekspertët e Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe u përkthye në shqip. IPF u përfshi në paketën e plotë të PZHS e PBA të DLDP, ku PZHS do të thotë planifikimi i zhvillimit strategjik, PBA – programi i buxhetit afatmesëm dhe e IPF elektronike.

Në verë 2012, IPF ishte gati për përdorim dhe iu shpërnda të gjitha bashkive shqiptare nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë. DLDP siguron trajnim dhe praktikë në terren për qeveri të përzgjedhura vendore; instrumenti është përdorur për planifikimin financiar afatmesëm në një numër gjithnjë e më të madh bashkish shqiptare, edhe në bashki që nuk ishin mbështetur nga dldp.

Në qershor 2017, kur ligji për vetëqeverisjen financiare vendore u miratua, u bë i detyrueshëm një përditësim i IPF. Ekspertët të IPF të dldp dhe ekspertët nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë identifikuan nevojat e ndryshme për korrigjim në bashkëpunim të ngushtë me mbështetësin e HSLU. Në instrumentin e përditësuar u riklasifikuan të ardhurat dhe shpenzimet, duke përfshirë një strukturë të re dhe uniforme programi mbështetur mbi klasifikimet ndërkombëtare të COFOG dhe GFS. Ky sistem i ri i klasifikimit mbështetur në standardet ndërkombëtare siguron standardizimin e klasifikimit të të ardhurave dhe shpenzimeve mes qeverisjes vendore. Gjithashtu përmes këtij klasifikimi do të sigurohet mundësia për të realizuar analizën e

detajuar në kohë dhe në raport me njëra tjetrën të njësive të ndryshme vendore. Për më tepër, të gjitha zërat e shpenzimeve të sistemit të klasifikimit janë të përshkruar saktësisht dhe është e mundur lidhja e rezultateve të i IPF me PBA.


Versioni final i IPF u bë gati për përdorim në shkurt 2018.

Qëllimi i manualit të IPF është t'u japë përdoruesve të njësive të vetëqeverisjes vendore një ndihmë të detajuar në përdorimin e IPF për përgatitjen e programeve buxhetore vjetore dhe afatmesme. Është synuar që manuali të botohet si një dokument dinamik që do të përditësohet rregullisht, duke iu përgjigjur çështjeve, shqetësimeve dhe pyetjeve të tjera të shpeshta të bëra nga zyrtarët shtetërorë dhe subjekte të tjera të interesuara.

2. Kuadri i përgjithshëm dhe struktura e instrumentit

Në kufijtë e fletëve do të gjeni skeda që ju lejojnë të hidheni nga njëra fletë te tjetra. Këto tituj janë me ngyra të ndryshme dhe secila ngjyrë përfaqëson një klasë të ndryshme fletësh, si tregohet në Figurën 1.

Figura 1: Tabelat me ngjyra paraqesin lloje të ndryshme fletësh



Në Tabelën 1 janë paraqitur klasa të ndryshme fletësh. Një dallim mund të bëhet midis fletëve input (me hyrje të dhënash) dhe output (me dalje të dhënash). Fletët në hyrje duhet të mbushen në mënyrë manuale, ndërsa fletët në dalje prodhohen automatikisht nga IPF. Për fletët e hyrjes duhet përcaktuar qartë përgjegjësia e krijimit të informacionit dhe përfshirjes së tij në formular. Përgjegjësitë e treguara në Tabelën 1 mund të përdoren si një zgjidhje standarde për përpunimin e formularëve.

Tabela 1: Klasat e fletëve të punës dhe karakteri i tyre

Kodi	Ngjyra e skedës	Përmbajtja e fletës	Karakteri i fletës	Përgjegjësia për hedhjen e të dhënave
A1	e gjelbër	Kopertina	Lexim	-
B1-B3	kaltër e lehtë	Informacion i përgjithshëm/Struktur organizative/Struktura Funksionale	Për plotësim	Departamenti i Buxhetit
C1-C6	portokalli	Shpenzimet e viteve të kaluara/Investimet e viteve të kaluara dhe viti aktual/Burimet e viteve të kaluara/Detyrimet e prapambetura/trashëgimi me destinacion/Angazhimet/Lista emërore e projekteve të investimeve	Për plotësim	Departamenti Financës
D 1 & D 2	vishnje e lehtë	Tavanet buxhetore/Llogaritjet makroekonomike	Për plotësim	Departamenti i Financës

Kodi	Ngjyra e skedës	Përmbajtja e fletës	Karakteri i fletës	Përgjegjësia për hedhjen e të dhënave
E 1	portokalli	Vlerësimi i burimeve	Për plotësim	-
KB 1-KB 27	e kuqe	Formularë të kërkesës buxhetore/Llogaritja e shpenzimeve të programit	Për plotësim	Departamente të linjës
F 1 & F 2	e gjelbër	Burimet buxhetore dhe shpenzimet sipas nënfunkcionit bruto (tabelë)	Lexim	-
F 3	e gjelbër e lehtë	Shpenzimet sipas nënfunkcionit bruto (grafik)	Lexim	-
F 4	e gjelbër	Shpenzimet sipas nënfunkcionit neto (tabelë)	Lexim	-
F 5	e gjelbër e lehtë	Shpenzimet sipas nënfunkcionit neto (grafik)	Lexim	-
F 6	e gjelbër	Shpenzimet bruto për çdo funksion (tabelë)	Lexim	-
F 7	e gjelbër e lehtë	Shpenzimet bruto për çdo funksion (grafik)	Lexim	-
F 8	e gjelbër	Shpenzimet sipas tipit të programit bruto (tabelë)	Lexim	-
F 9	e gjelbër e lehtë	Shpenzimet sipas tipit të programit bruto (grafik)	Lexim	-
F 10	e gjelbër e lehtë	Shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik bruto (tabelë)	Lexim	-
F 11	e gjelbër e lehtë	Shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik bruto (grafik)	Lexim	-
F 12	e gjelbër e lehtë	Plani i amortizimit të detyrimeve	Lexim	-
F 13	e gjelbër	Statistika financiare të përgjithshme	Lexim	-
F 14	e gjelbër	Treguesit	Lexim	-
F 15	e gjelbër e lehtë	Shpenzimet kapitale sipas programeve (tabelë)	Lexim	-
F 16	e gjelbër	Shpenzimet kapitale sipas programeve (grafik)	Lexim	-

Komanda të shkurtra

Për të gjetur informacionin me shpejtësi, është i mundshëm përdorimi i komandës “FIND” (gjej). Me anë të kësaj komande mund të gjendet me shpejtësi një kutizë/informacion me tastin e kërkuar në fletën e punës (Find in sheet) dhe në të tërë programin (Find in Workbook).

Nga rubrika HOME, gjeni komandën FIND and REPLACE dhe zgjidhni komandën FIND nga menuja kaskadë (rreshtat në zbritje). Plotësoni vlerën apo tekstin që kërkon dhe shtypni FIND NEXT. Nëse vlera apo teksti që kërkon gjendet, do të përzgjidhet automatikisht qeliza(t) që e përmban atë vlerë ose tekst. Shtypni FIND NEXT për të gjetur vlerat/tekstet e tjera identike; ose FIND ALL për të përzgjedhur të gjitha qelizat me tekstin/vlerën që kërkon.

Vini re: Në disa raste komanda find mund të jetë dhe si shortcut në rubrikën e sipërme të Excelit.

Kopjo figura

Kopjimi i figurave është i mundur me komandën snip ose screenshot, pra duke bërë një fotografi të pjesës së ekranit që ju intereson.

Për Windows 10, përzgjidhni butonin START dhe shtypni Snipping Tool në kutinë e kërkimit. Me këtë instrument mund të merrni dhe të ruani foto të një pjese apo të të gjithë ekranit.

Në mënyrë të ngjashme, komanda snapshot, me shortcutin ALT+PrTScr.

3. Skedat input

3.1. Informacion i përgjithshëm

Për secilin prej llojeve të ndryshme të skedave input më poshtë pason një instruksion i detajuar. Manuali shpjegon motivin e çdo skede; veç kësaj, ai jep udhëzim si mund të mbushet ajo. Vetëm në hapësirat e nënvizuara me të verdhë ose, sipas rastit, me ngjyrë ulliri, ka nevojë të plotësohet me informacion.

3.1. Titulli (A1)

Formulari “Titulli A1” prodhohet automatikisht. Ai përmban informacion për shtrirjen kohore të planit buxhetor, si dhe informacion njohës për administratën vendore, në formën e fletës hyrëse. Nuk kërkohen të dhëna për plotësim sepse rrjedh nga plotësimi i skedave të tjera pasardhëse.

3.2. Informacion i përgjithshëm (B1)

Përt'u plotësuar nga: Departamenti i Buxhetit/Financës

Formulari “B1 Informacion i përgjithshëm” përkufizon periudhën e planifikimit. Ky informacion përdoret për të përshtatur të gjithë formularët e seksionit C seksionit F dhe me titullin e faqes. Pjesa e poshtme e formularit përdoret për të plotësuar titullin e faqes.

Formulari B1 mbushet nga Departamenti i Financës. Plotëso në kutitë e verdha të mëposhtme:

1. Viti aktual: Lutemi, plotësoni vitin financiar në vazhdim; d.m.th. 2017, kur po përgatisni planin e buxhetit 2018–2020. Programi do të paraqesë automatikisht vitet e periudhës buxhetore që duhet planifikuar.

2. Blloku i dytë kërkon informacion të përgjithshëm për bashkinë, që përdoret për të plotësuar titullin e faqes (A1). Në veçanti, informacioni që duhet formuluar në këtë bllok kërkon edhe numrin e popullsisë dhe numrin e stafit që punon për administratën (mes tij stafin e përhershëm)

3. Në bllokun e tretë, duhet të zgjidhni midis futjes së të dhënave në lekë ose, në mënyrë alternative, në mijë/njëqind mijë ose million lekë or million Lek. Shtyp shigjetën në të djathtë të kutisë dhe zgjidh një prej opsioneve nga menuja kaskadë (Lek; 1000 Lekë; 100,000 Lekë; 1,000,000 Lekë). Lutemi, mbani mend zgjedhjen që keni bërë, për të ruajtur vazhdimësinë gjatë programit.

3.3. Organizata (B2)

Fleta “B2-Struktura Organizative” përcakton strukturën e nënfunksioneve/ programeve sipas departamenteve përgjegjëse. Emrat e nënfunksioneve janë të paracaktuara në linjë me klasifikimin buxhetor shqiptar, siç është miratuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Lista përfshin gjithsej 27 nënfunksione dhe 36 programe. Mbi emrat e nënfunksioneve/ programeve nuk mund të shkruhet dhe nuk mund të ndryshohen. Departamenti i Buxhetit/Financës është i ngarkuar të plotësojë këtë fletë pune.

Klasifikimi buxhetor është bazuar në klasifikimin e funksioneve¹⁾ të bazuar në standardet ndërkombëtare dhe kombëtare të klasifikimit, si më poshtë:

- 01 – Shërbime të përgjithshme publike
- 03 – Rendi dhe siguria publike
- 04 – Çështjet ekonomike
- 05 – Mbrojtja e mjedisit
- 06 – Strehimi dhe komoditetet e komunitetit
- 07 – Shëndetësia
- 08 – Argëtimi, Kultura dhe Feja
- 09 – Arsimi
- 10 – Mbrojtja sociale

Një apo më shumë prej fushave të programeve të buxhetit janë klasifikuar brenda secilit funksion kryesor. Çdo program është identifikuar me emrin e tij, si dhe me një kod të klasifikimit buxhetor pesëshifror. Kodet janë uniforme në të gjithë sistemin buxhetor dhe formojnë bazën e ekzekutimit të buxhetit nëpërmjet thesarit. Një përshkrim i përmbajtjes së politikës të çdo programi mund të gjendet në orientimin e PBA 2018.

Synimi kryesor i formularit B2 është lidhja e funksioneve/ nënfunksioneve me programet dhe dhënia e një kuadri të përgjithshëm të strukturës të buxhetit.

Për të plotësuar formularin B2, përcaktoni njësinë administrative përgjegjëse për çdo program; emrin e drejtuesit të programit/ njësisë në administratën vendore dhe numrin e punonjësve që janë të angazhuar me programin. (d.mth. punonjësit në njësi që punojnë në këtë program buxhetor). Ky informacion do të përdoret për Formularët e Kërkesës Buxhetore. Në fletën B2 do të duhet të plotësoni edhe numrin e pritshëm të punonjësve për secilin program gjatë viteve që mbulon PBA.

Informacioni i hedhur në këtë fletë përdoret për të përshtatur një seri formularësh input dhe output. Hyrjet e pasakta ose të paplota në këtë fazë nuk mund të korrigjohen në formularët pasues. Nuk është e mundur të mbishkruhet në hapësirat e nënvizuara me ngjyrë të kaltër safiri ose të hijëzuar me ngjyrë hiri.

1) COFOG – Classification of the Functions of Government, link: <https://unstats.un.org/unsd/cr/registry/regcst.asp?Cl=4>

Figura 2 : B2 - Organizimi

Verdhë = Per tu plotësuar nga Departamenti i Financës

(B2) STRUKTURA ORGANIZATIVE

Numër	Emri i Nënfunksionit	Drejtoria / Departamenti	Kryetari i programit	Numri i punonjësve			
				Viti aktual	Viti t+1 (I pritur)	Viti t+2 (I pritur)	Viti t+3 (I pritur)
Nënfunksioni 1	011 Organet ekzekutive dhe legjislative, për çështjet financiare dhe fiskale						
Nënfunksioni 2	017 Shërbime të huamarrjes vendore						
Nënfunksioni 3	031 Shërbimet Policore						
Nënfunksioni 4	032 Shërbimet e mbrojtjes ndaj zjarrit						
Nënfunksioni 5	036 Marrdheniet me komunitetin						
Nënfunksioni 6	041 Çështjet e përgjithshme ekonomike, tregtare dhe të punës						
Nënfunksioni 7	042 Bujqësia, pyjet, peshkimi dhe gjuetia						
Nënfunksioni 8	045 Transporti						
Nënfunksioni 9	047 Industri të tjera						
Nënfunksioni 10	051 Menaxhimi i i mbetjeve						
Nënfunksioni 11	052 Menaxhimi i ujrave të zeza						
Nënfunksioni 12	053 Reduktimi i ndotjes						
Nënfunksioni 13	056 Mbrojtja e mjedisit						
Nënfunksioni 14	061 Urbanistika						
Nënfunksioni 15	062 Zhvillimi i komunitetit						
Nënfunksioni 16	063 Furnizimi me ujë						
Nënfunksioni 17	064 Ndriçimi i rrugëve						
Nënfunksioni 18	072 Shërbimet e kujdesit parësor						
Nënfunksioni 19	081 Shërbimet rekreative dhe sportive						
Nënfunksioni 20	082 Shërbimet kulturore						
Nënfunksioni 21	091 Arsimi bazë dhe parashkollor						
Nënfunksioni 22	092 Arsimi parauniversitar						
Nënfunksioni 23	101 Sëmundje dhe paaftësi						
Nënfunksioni 24	102 Të moshuarit						
Nënfunksioni 25	104 Familje dhe fëmijë						
Nënfunksioni 26	105 Papunësia						
Nënfunksioni 27	106 Strehimi social						
				0	0	0	0

3.4. Struktura funksionale (B3)

Plotësohet nga: Departamenti i Buxhetit/Financës

Formulari “B3 – Struktura organizative” përdoret për të identifikuar programet për çdo nënfunksion dhe funksion. Termi “program” përdoret këtu për detyra të detajuara në vazhdim të njërive të vetëqeverisjes vendore; ky është niveli më i ulët i përdorur për klasifikimin buxhetor. Aktivitetet kanë një kod 5-shifror që përfshin kodin e nënfunksionit dhe atë të funksionit.

Një përshkrim i saktë i përmbajtjes së politikës që i përket çdo program mund të gjendet në udhëzimin standart të programit buxhetor afatmesëm për njësitë e vetëqeverisjes vendore..

IPF bën një dallim midis programeve të bazuar në natyrën e tyre, nëse ato janë të lidhura me një autoritet të vetëqeverisjes vendore, janë të deleguara, të transferuara rishtas ose funksione të veatit (menuja në Kolonën E). Rrjedhimisht, edhe programi bën një dallim midis funksioneve ligjore që janë “të detyrueshme” të kryhen dhe atyre që përfaqësojnë veprime shtesë mbi kërkesat ligjore (menuja kaskadë në Kolonën D).

Çdo program është i përcaktuar në IPF (automatikisht). Megjithatë në çdo nënfunksion ka të paktën një rresht bosh për të shtuar programe të reja që nuk janë përcaktuar në 9 funksionet bazë. Mirëpo, duhet që programet e shtuara në këtë hapësirë të mos jenë projekte të caktuara të cilat nuk përbëjnë program për njësinë e vetëqeverisjes vendore. Projektet kanë një fillim dhe një fund duke u lidhur kështu me një element konkret zhvillimi, ndërkohë që programet janë në vazhdim dhe shtrihen brenda një fushe të gjërë. Projektet duhet të përfshihen në programet përkatëse, si pjesë e tyre.

Departamenti i Buxhetit duhet të ndjekë këto hapa:

- Në secilin nënprogram, kontrolloni nëse janë përmendur të gjitha programet të cilat kryhen nga njësia e vetëqeverisjes vendore. Programet e paracaktuara mbështetur mbi udhëzimin janë shënuar automatikisht nga IPF si “të detyrueshme” dhe është caktuar tipi përkatës i autoritetit (d.m.th. nëse është i vet apo i deleguar tek NJVQV-ja)

- Shto/emërto programet shtesë, kur është e nevojshme. Shëno nëse ky program është “i detyrueshëm” (Kolona D); dhe nëse ai është “i vet” ose “i deleguar” (Kolona E).

Sugjerim: Në formularët e kërkesës buxhetore ka vend për maksimumi tre programe për çdo fushë të nënprogramit. Nëse kjo nuk është e mjaftueshme, shihni mundësinë e bashkimit të programeve të nënprogramit ose funksionit, për të kufizuar numrin e tyre deri në tre ose katër programe, kur kjo është e mundur. Veç kësaj, planifikimi në nivele më agregate ul mundësinë e gabimit.

Informacioni i B3 përdoret për të përshtatur një seri formularësh input dhe output. Hyrjet e pasakta ose të paplota në këtë fazë nuk mund të korrigjohen në formularët pasues. Nuk është e mundur të mbishkruhet në hapësirat e panënvizuara me të verdhë.

Figura 3 poshtë jep një ekstrakt të fletës B3 ²⁾. Përzgjidhni nga menuja kaskadë në dy kolonat e fundit, për të përcaktuar natyrën e aktiviteteve: nëse këto aktivitete janë të detyrueshme apo shtesë dhe nëse janë të lidhura me funksionet e veta, të deleguara apo të transferuara rishtas.

Figura 3: B3- Struktura funksionale

Verdhë = Per tu plotësuar nga Departamenti i Financës

(B3) PROGRAME PËR NËNFUNKSIONE DHE FUNKSIONE				
		Emri i programit	Programi: detyrueshme / shtesë	Programi: I veti / I deleguar / Transferuar
01 Shërbimet e Përgjithshme Publike				
Nënfunkcioni 1	011	Organet ekzekutive dhe legjislativë, për Çështjet financiare dhe fiskale, Çështjet e brendshme		
Programi 1a	01110	Planifikimi Menaxhimi dhe Administrimi	E detyrueshme	I veti
Programi 1b	01120	Çështje financiare dhe fiskale	E detyrueshme	I veti
Programi 1d	01170	Gjendja civile	E detyrueshme	I deleguar
Programi 1e				
Programi 1f				
Nënfunkcioni 2	017	Shërbime të huamarrjes vendore		
Programi 2d	01710	Pagesa për shërbimin e borxhit të brendshëm	E detyrueshme	I veti
Programi 2e				
03 Rendi dhe Siguria Publike				
Nënfunkcioni 3	031	Shërbimet Policore		
Programi 3a	03140	Shërbimet e Policisë Vendore	E detyrueshme	I veti
Programi 3b				
Programi 3c				
Nënfunkcioni 4	032	Shërbimet e mbrojtjes ndaj zjarrit		
Programi 4a	03280	Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	E detyrueshme	Transferuar
Programi 4b				
Programi 4c				
Nënfunkcioni 5	036	Marrdheniet me komunitetin		
Programi 5a	03600	Marrdheniet me komunitetin	E detyrueshme	I veti
Programi 5c				
04 Çështjet Ekonomike				
Nënfunkcioni 6	041	Çështjet e përgjithshme ekonomike, tregtare dhe të		
Programi 6b	04130	Mbështetje për zhvillimin ekonomik	E detyrueshme	I veti
Programi 6e	04160	Shërbimet e tregjeve, akreditimi dhe inspektim	E detyrueshme	I veti
Programi 6f				

2) IPF nuk ofron hapësirë për përshkrim të qartë të aktiviteteve. Rekomandohet që ky informacion të bëhet i disponueshëm si pjesë e përshkrimit të programit në PBA.

3.5. Shpenzimet e vitit të kaluar (C1)

Përt'u plotësuar nga: Departamenti i Buxhetit/Financës

Në formularin “C1 – Shpenzimet në vitet e kaluara”, shpenzimet dhe të ardhurat me destinacion të lidhura me programin (duke përfshirë projektet) janë formuluar në kuadrin e dy viteve të fundit dhe të vitit në vazhdim që konsiderohet dhe viti aktual. Formulari ndjek klasifikimin sipas programeve siç është paracaktuar në B2 dhe B3. Merrni informacion për dy vitet e fundit nga raporti financiar vjetor. Për vitin në vazhdim vendosni të dhëna për rezultatin e pritshëm buxhetor të fundvitit.

IPF e kopjon automatikisht informacionin në formatet e kërkesës buxhetore.

Së pari, formulari C1 kërkon informacion për shpenzimet bruto (totale) për çdo program për dy vitet e fundit dhe për vitin në vazhdim (i pritshëm); së dyti, kërkohet informacion për të ardhurat e mbartura me destinacion dhe tarifat. Informacioni për të ardhurat nga tarifat dhe të mbarturat me destinacion kërkohet sepse IPF do t'i paraqesë shpenzimet bruto dhe neto për çdo veprimtari në formularin e kërkesës buxhetore. Shembulli i mëposhtëm shpjegon logjikën e kësaj ideje të plotësimit të këtij formati. Të supozojmë që një NJVQV e përmirëson sistemin e saj të grumbullimit të mbetjeve, duke përdorur sistemin e mbledhjes së diferencuar. Shpenzimi bruto është 1,000,000 lekë dhe tarifa: 500,000 lekë, kontributi nga një donatori: 200,000 lekë. Kjo do të thotë që shpenzimi neto është vetëm 300,000 lekë. Pse është i rëndësishëm ky informacion? Ndoshta këshilli dëshiron të vlerësojë kostot pa mbledhjen e diferencuar të mbetjeve. Shpenzimi bruto sigurisht do të jetë më i ulët, por ndoshta donatorë të ndryshëm nuk do të dojë të paguajë kontribut.

Një ekstrakt të këtij formulari e gjeni në Figurën 4. Departamenti i Buxhetit/Financës mbush vetëm hapësirat e verdha të formularit C1. Më pas, departamentet e tjera do ta përdorin këtë informacion si pikënisje për të planifikuar buxhetet e tyre.

Figura 4. C1 Shpenzimet: Vitet e kaluara dhe viti aktual

Verdhë = Per tu plotësuar nga Departamenti i Financës															
(C1) SHPENZIMET: VITET E KALUARA DHE VITI AKTUAL															
				-2				-1				0			
				Viti t-2				Viti i shkuar				Viti aktual			
				SHUMA E KËRKUAR NETO	Shpenzimet (Përfshirë Investimet)	Tarifa	Të ardhura me destinacion	SHUMA E KËRKUAR NETO	Shpenzimet (Përfshirë Investimet)	Tarifa	Të ardhura me destinacion	SHUMA E KËRKUAR NETO	Shpenzimet (Përfshirë Investimet)	Tarifa	Të ardhura me destinacion
01 Shërbimet e Përgjithshme Publike															
Nënfunkcioni 1	011	Organet ekzekutive dhe legjislativë, per Çështjet financiare dhe fiskale, Çështjet e brendshme													
Programi 1a	01110	Planifikimi Menaxhimi dhe Administrim	0				0					0			
Programi 1b	01120	Çështje financiare dhe fiskale			0					0				0	
Programi 1d	01170	Gjendja civile			0					0				0	
Programi 1e	-		0				0					0			
Programi 1f	-		0				0					0			
			0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Nënfunkcioni 2	017	Shërbime të huamarrjes vendore													
Programi 2d	01710	Pagesa për shërbimin e borxhit të brendshëm	0				0					0			
Programi 2e	-		0				0					0			
			0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
03 Rendi dhe Siguria Publike															
Nënfunkcioni 3	031	Shërbimet Policore													
Programi 3a	03140	Shërbimet e Policisë Vendore			0					0				0	
Programi 3b	-		0				0					0			
Programi 3c	-		0				0					0			
			0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Nënfunkcioni 4	032	Shërbimet e mbrojtjes ndaj zjarrit													
Programi 4a	03280	Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	0				0					0			
Programi 4b	-		0				0					0			
Programi 4c	-		0				0					0			
			0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Nënfunkcioni 5	036	Marrdheniet me komunitetin													
Programi 5a	03600	Marrdheniet me komunitetin	0				0					0			
Programi 5c	-		0				0					0			
			0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0

Kategoritë e të dhënave për secilin program buxhetor në fletën C1 janë ndarë si më poshtë:

- Shpenzimet e përgjithshme për programin (Totali i fondit që nevojitet për programin);
- Tarifat e mbledhura me destinacion për këtë program, sipas parimit që tarifat duhet të financojnë shërbimin për të cilin janë mbledhur (si në shembullin më lart);
- Të ardhurat me destinacion (p.sh. transfertat të kushtëzuara të cilaj janë me destinacion për financimin e programit dhe nuk mund të ndryshohet natyra e përdorimit të tyre).

Diferenca mes shpenzimeve të përgjithshme të programit me shumën e tarifave dhe të ardhurave të tjera me destinacion do të japë kërkesën neto buxhetore për financimin e programit nga buxheti i përgjithshëm i njësisë së vetëqeverisjes vendore (kolona e gjelbër, shuma e kërkuar neto).

3.6. Investimet e vitit të kaluar (C1B)

Përt' u plotësuar nga: Departamenti i Buxhetit/Financës

Në formularin “C1b – Investimet e vitit të kaluar”, janë paraqitur investimet kapitale për vitin në vazhdim (rezultati i pritshëm i fundvitit) dhe i dy viteve të mëparshme financiare. Ky formular ndjek strukturën e programeve, nënprogrameve dhe funksioneve siç është paraqitur në B1 – B3; dhe të njëjtë si në C1: Shpenzimet e vitit të kaluar. Të dhënat duhet të plotësohen në kutitë e verdha për çdo vit të shqyrtuar.

Figura 5. C1b Investimet: Vitet e kaluara dhe viti aktual

Verdhë = Per tu plotësuar nga Departamenti i Financës					
(C1b) INVESTIMET: VITET E KALUARA DHE VITI AKTUAL					
			-2	-1	0
			Investimet	Investimet	Investimet
01 Shërbimet e Përgjithshme Publike					
Nënfunkcioni 1	011	Organet ekzekutive dhe legjislative, per Çështjet financiare dhe fiskale, Çështjet e brendshme			
Programi 1a	01110	Planifikimi Menaxhimi dhe Administrimi			
Programi 1b	01120	Çështje financiare dhe fiskale			
Programi 1d	01170	Gjendja civile			
Programi 1e	-	-			
Programi 1f	-	-			
			0	0	0
Nënfunkcioni 2	017	Shërbime të huamarrjes vendore			
Programi 2d	01710	Pagesa për shërbimin e borxhit të brendshëm			
Programi 2e	-	-			
			0	0	0
03 Rendi dhe Siguria Publike					
Nënfunkcioni 3	031	Shërbimet Policore			
Programi 3a	03140	Shërbimet e Policisë Vendore			
Programi 3b	-	-			
Programi 3c	-	-			
			0	0	0

Në këtë format është e rëndësishme plotësimi i nivelit të shpenzimeve që njësia e vetëqeverisjes vendore ka realizuar në vitet e shkuara për investime në nivel programi, me qëllim identifikimin e trendit të shpenzimeve në vite.

3.7. Burimet e vitit të kaluar (C2)

Përt'u plotësuar nga: Departamenti i Taksave/Të ardhurave
 Departamenti i Buxhetit/Financës

Në formularin “C2 – Burimet buxhetore të viteve të kaluara”, burimet për vitin në vazhdim (rezultati i pritshëm i fundvitit) dhe të dy viteve të mëparshme janë përfshirë në një kuadër. Një ekstrakt të këtij formulari e gjeni në Figurën. 6. Ky formular ndjek klasifikimin konvencional të të ardhurave vendore dhe burimeve të fitimit sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor në Republikën e Shqipërisë.

Kategoritë kryesore të burimeve të buxhetit janë paraqitur si më poshtë:

1. Të ardhura nga burimet e veta:

- a. Taksa vendore mbi bizneset e vogla
- b. Taksë mbi pasuritë e paluajtshme (3 lloje)
- c. Taksa e hotelit
- d. Taksa e ndikimit të infrastrukturës
- e. Taksë table
- f. Taksë vendore mbi donacionet etj.
- g. Taksa të përkohshme (3 lloje)

2. Të ardhura nga taksat e ndara (ndarë në 5 kategori);

3. Të ardhura nga tarifatat dhe tarifatat e shërbimeve (pasojnë nën ndarjet që janë përcaktuar në Ligjin e Financave Vendore);

4. Të hyra të tjera, duke përfshirë të ardhurat jotatimore, si të ardhurat nga gjambat, shitjet apo qiradhënia e aseteve, të hyra nga asetet ose aktivitete të tjera ekonomike, transferime dhe donacione etj;

5. Të hyra nga buxheti i shtetit: tranderta të pakushtëzuara ose të kushtëzuara, duke përfshirë ndarjen sipas llojeve;

6. Të hyra nga huatë;

7. Të mbartura nga vitet e kaluara.

Vini re: Fondet e mbartura nga viti i kaluar përfshijnë:

Të mbartura pa destinacion: Të ardhura të përgjithshme në buxhetin e bashkisë, të cilat nuk janë shpenzuar gjatë vitit në vazhdim, për shembull për shkak të tejkalimit të planit. Këto janë tipikisht të ardhurat shtesë nga taksat vendore, transfertat e pakushtëzuara apo fonde të tjera të pashpenzuara (dhe të pabuxhetuara specifiku në vitin paraardhës);

Të mbartura me destinacion: Të ardhurat e mbartura me destinacion janë të ardhurat nga tarifatat vendore për shërbime specifike, të cilat nuk janë shpenzuar gjatë vitit në vazhdim; por të cilat duhet të vijojnë të shpenzohen për të njëjtin program edhe në vitin e ardhshëm buxhetor (p.sh. tejkalim i planit nga tarifa e pastrimit); fonde nga transfertat të kushtëzuara, specifike apo donacione të cilat mund të mbarten në buxhet, por që mund të shpenzohen vetëm për qëllimin e paracaktuar edhe gjatë vitit të ardhshëm buxhetor.

Merrni informacion për vitin e kaluar nga raporti financiar vjetor dhe për vitin në vazhdim nga përlogaritjet për buxhetin e vitit në vazhdim/rezultati i pritshëm i fundvitit. Ky informacion përdoret si pikënisje për përlogaritjen e të ardhurave me anë të formularëve E1 deri E5. Informacioni kopjohet automatikisht në këta formularë.

Figure 6 : C2 - Burimet buxhetore të vitit të kaluar

Verdhë = Per tu plotësuar nga Departamenti i Financës					
(C2) VLERËSIMI I BURIMEVE BUXHETORE					
			-2	-1	0
Lloji i të ardhurava		Kodi	Viti t-2	Viti i shkuar	Viti aktual
TË ARDHURA NGA BURIMET E VETA		A	-	-	-
TË ARDHURA NGA TAKSAT LOKALE		A.1	-	-	-
Taksa vendore mbi biznesin e vogël		A.1.1			
Taksa mbi pasurinë e paluajtshme		A.1.2		-	-
Taksa mbi ndërtesën		A.1.2.1			
Taksa mbi tokën bujqësore		A.1.2.2			
Taksa mbi truallin		A.1.2.3			
Taksa mbi transaksionet e pasurisë		A.1.2.4			
Taksa vendore në shërbimin hotelier		A.1.3			
Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja		A.1.4			
Taksa e tabelës		A.1.5			
Taksa vendore mbi të ardhurat e krijuara nga dhuratat, trashëgimi, testament dhe llotaritë vendore		A.1.6			
Taksa e përkohëshme	aaa	A.1.7			
Taksa e përkohëshme 1	bbb	A.1.8			
Taksa e përkohëshme 2	ccc	A.1.9			
TË ARDHURA NGA TAKSAT E NDARA (GRANTE)		A.2	-	-	-
Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë / pasuritë e paluajtshme		A.2.1			
Taksa vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorura		A.2.2			
Taksa e rentës minerare		A.2.3			
Taksa mbi të ardhurat personale		A.2.4			
Taksa të tjera		A.2.5			
TË ARDHURA NGA TARIFA VENDORE		A.3	-	-	-
Tarifa me menaxhimin të mbetjeve		A.3.1		-	-
Tarifa e pastrimit për familjet		A.3.1.1			
Tarifa e pastrimit për institucionet		A.3.1.2			
Tarifa e pastrimit për biznesin		A.3.1.3			
Tarifa për mbledhjen dhe largimin e mbetjeve		A.3.2			
Tarifa për ndriçimin publik		A.3.3	-	-	-
Tarifa për ndriçimin publik nga familjet		A.3.3.1			
Tarifa për ndriçimin publik nga institucionet		A.3.3.2			
Tarifa për ndriçimin publik nga biznesi		A.3.3.3			
Tarifa për gjelbërimin		A.3.4	-	-	-
Tarifa për gjelbërimin nga familjet		A.3.4.1			
Tarifa për gjelbërimin nga institucionet		A.3.4.2			
Tarifa për gjelbërimin nga bizneset		A.3.4.3			
Tarifa për shërbimet administrative të bashkisë		A.3.5	-	-	-
Tarifa për shërbimet administrative të bashkisë		A.3.5.1			
Tarifa për dhënie të lejeve, lejeve e autorizimeve		A.3.5.2			
Tarifa të kontrollit të zhvillimit të territorit		A.3.5.3			
Tarifa për vulosje veterinarie të bagëtive të therura		A.3.5.4			
Tarifa e licënsimit të veprimtarive të transportit		A.3.5.5			
Tarifa e parkimit për mjetet e licënuara dhe vendparkime publike		A.3.5.6			
Tarifa për dhënie licëns për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj		A.3.5.7			
Tarifa për pyejt dhe kullotat		A.3.5.8			
Tarifa për shërbimet shtesë nga zjarrëfiksja		A.3.5.9			
Tarifa për zënie dhe përdorimin e hapësirës publike dhe fasadave		A.3.5.10			
Tarifa për trajtimin e mbetjeve inerte në landfille		A.3.5.11			
Tarifa për linjat ajrore dhe nëntoksores (Telefoni, Energji, TV Kabllor, Internet)		A.3.5.12			
Tarifa nga dokumentat për tender, ankand etj		A.3.5.13			

3.8. Të prapambetura (C3)

Përt'u plotësuar nga: Departamenti i Buxhetit/Financës

Fleta "C3 – Të prapambetura", mban vlerën e detyrimeve të prapambetura që nuk janë shlyer në afatin e caktuar. Ajo synon të paraqesë një tablo të detyrimeve të vonuara dhe të sigurojë që të hartohet një plan i shlyerjes së këtyre detyrimeve brenda të paktën një periudhe afatmesme.

Departamenti i Buxhetit/ Financës duhet të specifikojë:

- Emrin e kreditorit dhe datën në të cilën ka lindur detyrimi i prapambetur (Kolona A dhe B);
- Të dhënat mbi kreditorin mund të specifikohen edhe në programin përkatës ku ka lindur detyrimi;
- Stoku i borxhit (d.mth. sasia e detyrimit të vonuar) më 31 tetor të vitit financiar në vazhdim (Kolona C);
- Plani për shlyerjen e detyrimit të prapambetur, nëse me pagesa periodike (kolonat E, H, K, N për vitet t, t+1; t+2 and t+3 përkatësisht)

Figura 7 : C3 – Detyrimet e prapambetura

Verdhë = Per tu plotësuar nga Departamenti i Financës										
(C3) DETYRIMET E PRAPAMBETURA										
		0	0		1		2		3	
		Viti aktual	Viti aktual		Viti t+1 (I pritur)		Viti t+2 (I pritur)		Viti t+3 (I pritur)	
Kreditor	Data e Detyrimit	Stoku i borxhit, 31 Tetor	Amortizimi i detyrimeve të prapambetura deri në fund të vitit	Stoku i borxhit, 31 Dhjetor	Amortizimi i detyrimeve të prapambetura gjatë vitit	Stoku i borxhit, 31 Dhjetor	Amortizimi i detyrimeve të prapambetura gjatë vitit	Stoku i borxhit, 31 Dhjetor	Amortizimi i detyrimeve të prapambetura gjatë vitit	Stoku i borxhit, 31 Dhjetor
			0	0	0	0	0	0	0	0 OK!
			0	0	0	0	0	0	0	0 OK!
			0	0	0	0	0	0	0	0 OK!
			0	0	0	0	0	0	0	0 OK!
			0	0	0	0	0	0	0	0 OK!

Kolonat në ngjyrë hiri do të nxjerrin automatikisht stokun e borxhit të prapambetur në fund të çdo periudhe financiare. Të dhënat e plotësuara në këtë fletë shërbejnë për qëllim informacioni dhe dokumentacioni. Këto të dhëna nuk reflektohen në asnjë prej tabelave të mëvonshme, por njësia e vetëqeverisjes vendore duhet të shpërndajë planin për amortimin e detyrimeve të prapambetura sipas programeve përkatëse të kërkesave buxhetore.

3.9. Të mbartura me destinacion (C4)

Përt'u plotësuar nga: Departamenti i Buxhetit/Financës

Fleta C4 tregon fondet e trashëguara me destinacion në përputhje me klasifikimin e programeve të njësisë së vetëqeverisjes vendore. Qëllimi i kësaj flete është të sigurohet që detyrimet në shpenzime që nuk janë respektuar në vitin financiar paraardhës të dokumentohen dhe të trashëgohen në vitin pasardhës për tu përdorur me atë destinacion. Fondet e mbartura janë rezultat i diferencës midis shumës së parashikuar nga programi/ nënprogrami/ funksioni në vitin buxhetor në vazhdim dhe shpenzimeve të kryera realisht. Nëse diferenca është pozitive, departamenti i financës duhet të kujdeset të identifikojë arsyen e diferencës dhe të argumentojë qartë këtë diferencë të krijuar. Si shembull i arsyes së trashëgimit mund të jetë kursimi i realizuar nëpërmjet blerjes së mallrave dhe shërbimeve me një çmim më të ulët tregu nga ç'është përlogaritur fillimisht. Megjithatë në rastet e projekteve të investimeve kapitale, kur një shpenzim nuk është kryer për shkak të pengesave teknike ose kohore, mund të jetë me vend që të identifikohen fondet e mbartura si të angazhuara, për të vazhduar shpenzimin kapital në vitin e ardhshëm.

Figura nr.8 (C4) Trashëgimi me destinacion

Verdhë = Per tu plotësuar nga Departamenti i Financës			
(C4) TRASHËGIMI ME DESTINACION			
			1
			Trashëgimi me destinacion
Nënfunkcioni 1	011	Organet ekzekutive dhe legjislative, per Çështjet financiare dhe fiskale, Çështjet e brendshme	
Programi 1a	01110	Planifikimi Menaxhimi dhe Administrimi	
Programi 1b	01120	Çështje financiare dhe fiskale	
Programi 1d	01170	Gjendja civile	
Programi 1e	-	-	
Programi 1f	-	-	
			0
Nënfunkcioni 2	017	Shërbime të huamarrjes vendore	
Programi 2d	01710	Pagesa për shërbimin e borxhit të brendshëm	
Programi 2e	-	-	
			0
Nënfunkcioni 3	031	Shërbimet Policore	
Programi 3a	03140	Shërbimet e Policisë Vendore	
Programi 3b	-	-	
Programi 3c	-	-	

Lutemi vini re që fonde të tilla përsëri kanë nevojë të jenë të përcaktuara në buxhetin vjetor (d.m.th. në formatin e kërkesës buxhetore) me qëllim që të bëhen të disponueshme për programin/nënprogramin/ funksionin.

Informacioni i futur në këtë fletë i shtohet automatikisht llogaritjes së shpenzimit të programit në formularët e kërkesës buxhetore përvitin t+1.

3.10. Angazhimet (C5)

Përt'u plotësuar nga: Departamenti i Buxhetit/Financës

Fleta C5 tregon të gjitha angazhimet shumëvjeçare të marra në vitin buxhetor të kaluar dhe për vitet në vazhdim në nivel programi buxhetor. Qëllimi është përfshirja e tyre në programin buxhetor afatmesëm, në mënyrë që të bëhet e mundur shmangia e lindjes së detyrimeve të prapambetura. Nëpërmjet përcaktimit të anagazhimeve buxhetore njësisë së vetëqeverisjes vendore i rikujtohet gjatë planifikimit buxhetore pjesa e buxhetit që është e detyruar të rialokojë përvitin e ardhëm buxhetor.

Angazhimet janë detyrimet financiare të marra përsipër nga njësi shpenzuese, të cilat rrjedhin nga kontrata për shpenzime kapitale, blerjen e mallrave apo shërbimeve, si edhe kontrata e shërbimit (jashtëkontraktimi i shërbimeve); pra çdo lloj detyrimi që rrjedh nga marrëveshjet me palë të treta. Bashkia duhet të ofrojë një pasqyrë të përgjithshme të angazhimeve në fuqi në fillim të vitit buxhetor; përt'u siguruar që:

- 1) Këto detyrime do të plotësohen dhe nuk do të anashkalojnë dhe
- 2) Që këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore të ketë një pasqyrë të plotë të fondeve që janë efektive të lira për t'u akorduar gjatë vitit buxhetor. Për shembull, nëse në programin e mbetjeve janë parashikuar gjithsej 100 mijë lekë, ndër të cilat 50 mijë lekë do të shkojnë në vit për kompaninë e pastrimit dhe 30 mijë lekë janë parashikuar që në vitin paraardhës për vazhdimin e investimit në landfill; efektive vetëm 20 mijë lekë janë të lira për t'u akorduar nga këshilli në vitin e parë të buxhetit për të arritur objektivat.

Figura nr.9 (C5) Angazhimet

Verdhë = Per tu plotësuar nga Departamenti i Financës					
(C5) ANGAZHIMET					
			1	2	3
			Angazhimet	Angazhimet	Angazhimet
Nënfunkcioni 1	011	Organet ekzekutive dhe legjislative, per Çështjet financiare dhe fiskale, Çështjet e brendshme			
Programi 1a	01110	Planifikimi Menaxhimi dhe Administrimi			
Programi 1b	01120	Çështje financiare dhe fiskale			
Programi 1d	01170	Gjendja civile			
Programi 1e	-	-			
Programi 1f	-	-			
			0	0	0
Nënfunkcioni 2	017	Shërbime të huamarrjes vendore			
Programi 2d	01710	Pagesa për shërbimin e borxhit të brendshëm			
Programi 2e	-	-			
			0	0	0
Nënfunkcioni 3	031	Shërbimet Policore			
Programi 3a	03140	Shërbimet e Policisë Vendore			
Programi 3b	-	-			
Programi 3c	-	-			
031			0	0	0
Nënfunkcioni 4	032	Shërbimet e mbrojtjes ndaj zjarrit			
Programi 4a	03280	Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile			
Programi 4b	-	-			
Programi 4c	-	-			
031			0	0	0

Autorizimi për angazhime paraprake për projekte investimesh dhe shpenzime të tjera periodike është i mundur në sistemin buxhetor dhe si rrjedhim këto angazhime në periudhë afatmesme duhet të regjistrohen. Megjithatë, që pagesat të bëhen efektive brenda çdo programi, janë të nevojshme autorizimet vjetore. Kjo fletë shërben në radhë të parë për qëllime informacioni dhe dokumentimi. Shifrat për angazhimin futen automatikisht si informacion në formularët përkatës të kërkesës buxhetore.

3.11. Lista emërore e projekteve të investimeve

Përt'u plotësuar nga: Departamenti i Buxhetit/Financës

Në IPF është përcaktuar një tabelë e veçantë për të renditur projektet e investimeve që njësia e vetëqeverisjes vendore ka parashikuar në buxhetin afatmesëm. Në këtë tabelë të dhënat janë të detajuara në kolona të cilat do të shënohet, emërtimi i projektit, vlera e kontratës dhe shpërndarja e financimit në dy vitet e shkuara vitin aktual dhe në tre vitet e ardhshme buxhetore. Në fushat me të verdha do të plotësohet informacioni sipas përcaktimeve të mësipërme.

Në fund të tabelës do të jetë shuma e investimeve të cilat janë parashikuar nga njësia e vetëqeverisjes vendore për tu realizuar sipas viteve por edhe në periudhë afatmesme.

Figura 11: Tavanet buxhetore

Verdhë = Per tu plotësuar nga Departamenti i Financës

(D1) TAVANET				
		1	2	3
		Viti t+1 (I pritur)	Viti t+2 (I pritur)	Viti t+3 (I pritur)
Nënfunkcioni 1	011 Organet ekzekutive dhe legjislative, për çështjet			
Pagat dhe sigurimet shoqërore		0	0	0
Të tjera shpenzime korrente		0	0	0
Shpenzimet kapitale		0	0	0
Tavanet e përgjithshme		0	0	0
Angazhimet kujtesë		0	0	0
01110	Planifikimi Menaxhimi dhe Administrimi			
Pagat dhe sigurimet shoqërore				
Të tjera shpenzime korrente				
Shpenzimet kapitale		0	0	0
Tavanet e përgjithshme				
Angazhimet kujtesë		0	0	0

Në fletën D1, në rreshtat 489:491 parashikohen fondet rezervë dhe të kontigjencës, të cilat sipas ligjit të buxhetit nuk duhet të kalojnë 3% të buxhetit të bashkisë. Drejtoria e buxhetit duhet të plotësojë përqindjen për fondin rezervë dhe të kontigjencës në secilin nga vitet t+1, t+2 dhe t+3 dhe programi do të gjenerojë vlerat absolute në varësi të buxhetit të formuluar.

3.13 Parashikimet makroekonomike (D2)

Parashikimet makroekonomike të formularit D2 japin informacion për shifrat përkatëse të përlogaritura nga konteksti makroekonomik, të cilat prekin buxhetin afatmesëm. Ky informacion përdoret në çdo fazë të procesit të hartimit të buxhetit, d.m.th. përgatitjen e buxhetit, vlerësimin e propozimit për buxhetin dhe miratimin e tij, ekzekutimin e buxhetit dhe kontrollin e mëvonshëm. Këto parashikime janë thelbësore për procesin e buxhetit; ato duhet të bazohen në përlogaritjet e institutive parashikuese të kualifikuara dhe të njohura përgjithësisht dhe të konfirmohen në nivel politik, d.m.th. nga kryetari i bashkisë, përpara se të bëhen zyrtare. Në shumicën e rasteve, parashikimet makroekonomike të NjQV mund të mbështeten në parashikimet e planifikimit të përdorura nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë në kuadrin makroekonomik. Këto parashikime u bëhen të njohura NJQV-ve nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë çdo vit përmes udhëzimit vjetor të përgatitjes së buxhetit por edhe për. Megjithatë rritja ekonomike ose inflacioni mund të jenë më të larta se mesatarja kombëtare në zonat me rritje të shpejtë ekonomike. E kundërta mund të ndodhë në zonat rurale të vendit. Rekomandohet që të pasqyrohen parashikimet e planifikimit dhe të përshtaten ato në mënyrë të matur me realitetet vendore. Kur parashikimet e planifikimit devijojnë nga përlogaritjet kombëtare, arsyet duhet të shpjegohen në mënyrë të detajuar. Lutemi të vihet re që parashikimet makroekonomike nuk përdoren automatikisht për përlogaritjen e të ardhurave ose shpenzimeve. Çdo NjQV duhet ta marrë parasysh këtë informacion dhe të vlerësojë ndikimin e inflacionit të parashikuar, rritjes reale ekonomike etj. Mbi të ardhurat dhe shpenzimet nën kontrollin e tij të drejtpërdrejtë.

Departamenti i Buxhetit/Financës plotëson informacionin për parashikimet makroekonomike dhe ua komunikon të gjitha departamenteve të interesuara, në mënyrë që të kuptohen qartë tendencat e zhvillimit makroekonomik të njësisë për perioidhuën buxhetore afatmesme. IPF paracakton gjashtë tregues ekonomikë; ka vend për tregues shtesë që konsiderohen të rëndësishme për NjQV-të. Formulari “D2 Prarashikimet makroekonomike” është paraqitur në Figurën 12.

Figura 12 D2: Parashikimet makroekonomike

Verdhë = Per tu plotësuar nga Departamenti i Financës						
(D2) LLOGARITJET MAKROEKONOMIKE						
	-2	-1	0	1	2	3
	Viti t-2	Viti i shkuar	Vitit aktual (I pritur)	Viti t+1 (I pritur)	Viti t+2 (I pritur)	Viti t+3 (I pritur)
Norma e inflacionit						
Norma reale e rritjes ekonomike						
Norma e rritjes së pagave (nominale)						
Norma e Interesit (3 mujor)						
Norma e Interesit (5 vjeçar)						
Kursi i këmbimit (në fund të vitit) shuma në LEK për 1 EURO						

3.14. Përlllogaritja e të ardhurave: Vlerësimi i Burimeve Buxhetore (E1)

Përt'u plotësuar nga: Departamenti i të Ardhurave

Formulari E1 përdoret për të parashikuar të gjitha klasat e të ardhurave vendore. Informacioni për disa burime të ardhurash nuk do të jetë objekt i përlllogaritjeve vendore, si të dhënat për grantet ndërqeveritare që akordohen nga buxheti qëndror. Disa burime të tjera, në veçanti burimet e veta të të ardhurave, duhet të përlllogariten gjatë procesit të përgatitjes së buxhetit. Së fundi, vija e mbledhjes e këtij formulari tregon burimet e përgjithshme buxhetore për çdo vit. Ajo paraqet gjithashtu nëntotalin sipas llojit të të ardhurave; d.m.th. totali i taksave, totali i tarifave, totali i granteve etj.

IPF kërkon që cdo taksë dhe tarifë të përlllogaritet më vete. Sidoqoftë, procedura është mjaft e ngjashme për secilën prej tyre. Megjithatë, faktorët që mund të kenë impakt mbi taksat nuk janë gjithmonë të njëjtët me ato që kanë impakt për tarifat.

IPF merr parasysh pesë faktorë ndikues mbi taksat, si më poshtë: (1) rritja reale ekonomike, (2) inflacioni; (3) rritja e popullsisë, (4) rregullimi (modifikimi ligjor i ligjit të taksave), (5) përdorimi i përmirësuar i potencialit të taksave, (6) ndryshimet e nivelit të taksave; (7) të tjera.

Informacioni për faktorët ndikues mund të merret nga parashikimet ekonomike, por një pjesë duhet supozuar mbi bazën e një metodologjie logjike të caktuar. Kjo është vështirësia e parë që rrjedh nga parashikimi i të ardhurave sipas kësaj metode. Specialistët e taksave të NjQV-ve duhet të vlerësojnë ndikimin e secilit prej faktorëve ndikues mbi secilën taksë me qëllim nxjerrjen e rezultatit. Kjo është vështirësia e dytë që paraqitet në llogaritje. Është e qartë që disa faktorë në hyrje janë më të rëndësishëm për disa taksë se për të tjerat. Për shembull, rritja ekonomike shpresohet të ketë ndikim pozitiv mbi taksën e ndikimit në infrastrukturë, por jo në taksën e ndërtimit që është një taksë e sheshtë. Megjithatë, për të vlerësuar masën e këtij ndikimi mbi një taksë të caktuar kërkohet një përvojë e madhe dhe një metodë e saktë llogaritjeje. Përdorimi i aftësive statistikore nuk mund ta zëvendësojë përvojën prandaj gjatë parashikimeve duhet të vihet në funksion ndërthurja e të dyjave. Ka vetëm një rrugë për ta bërë këtë: të provosh, të diskutosh për gabimet në përlllogaritje dhe të mësosh prej tyre.

Në Figurën 13, mund të shikoni një ekstrakt të formularit “E1 – Vlerësimi i burimeve”; këtu paraqitet informacion për dy taksë: e ndërtesave dhe e transaksioneve të pasurisë. Në pjesën e sipërme gjeni rubrikat për shtatë faktorët ndikues; sfondi i fushave është mbajtur i bardhë. Poshtë, në fushat e verdha, mund të plotësoni ndikimin e pritshëm të secilit prej faktorëve ndikues mbi taksën përkatëse për secilin vit. Ndryshimi në % i referohet gjithmonë vitit paraardhës; p.sh. ndryshimi i pritshëm për 2018-ën është ndryshimi në përqindje i pritshëm në krahasim me rezultatin e 2017-ës.

Figura 13: E1 – Vlerësimi i burimeve buxhetore

Për tu plotësuar nga Departamenti i Financës			
(E1) VLERËSIMI I BURIMEVE BUXHETORE			
	-2	-1	0
	Viti t-2	Viti i shkuar	Viti aktual
TË ARDHURA NGA BURIMET E VETA	-	-	-
TË ARDHURA NGA TAKSAT LOKALE	-	-	-
Taksa vendore mbi biznesin e vogël	-	-	-
Taksa mbi pasurinë e paluajtshme	-	-	-
Taksa mbi ndërtesën	-	-	-
Taksa mbi tokën bujqësore	-	-	-
Taksa mbi truallin	-	-	-
Taksa mbi transaksionet e pasurisë	-	-	-
Taksa vendore në shërbimin hotelier	-	-	-
Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja	-	-	-
Taksa e tabelës	-	-	-
Taksa vendore mbi të ardhurat e krijuara nga dhuratat, trashëgimi, testament	-	-	-
Taksa e përkohëshme	aaa	-	-
Taksa e përkohëshme 1	bbb	-	-
Taksa e përkohëshme 2		-	-

Të dyja rastet e paraqitura në figurën 13 janë të ndryshme.

- Taksa e parë, pra taksa e ndërtesës, është shembull për një taksë të vendosur rishtas. Le të supozojmë që në vitet e mëparshme nuk ka pasur të ardhura tatimore nga ky burim. Në rastin e një takes të vendosur rishtas, përdorni fushat në ngjyrë ulliri për vitin e futjes së taksës dhe vëllimin e pritshëm për vitin e parë. Shënoni vëllimin për vitin e parë – në shembullin tonë viti i futjes së taksës së re është viti t+1 - 2018. Ne aktualisht jemi në vitin t; ky është viti i buxhetit në vazhdim. Pra, t+1 është viti pas këtij. Për këtë arsye ju duhet të vlerësoni ndikimin e faktorëve ndikues vetëm për vitet t+2 dhe t+3, siç është bërë në shembullin tonë.

- Taksa e dytë, d.m.th. taksa e transaksionit të pasurisë, është një shembull për një taksë që ekziston tashmë. Ju i gjeni të ardhurat e kësaj take për vitin e kaluar dhe vitin në vazhdim në përputhje me pasqyrën financiare vjetore dhe rezultatin e pritshëm të buxhetit të vitit në vazhdim në fushën portokalli në rreshtin e parë të kësaj take. Në këtë rast, pikënisja për parashikimin është rezultati i pritshëm i vitit në vazhdim. (Mos përdorni të dhëna nga plani i vitit në vazhdim, kjo mund të jetë çorientuese). Plotësoni përqindjen e pritshme të impaktit të faktorëve përkatës për vitet e ardhshme. Në shembullin tonë ne marrim dy faktorë ndikues për vitin e parë dhe tre për vitin e dytë:

- Supozojmë që do të ketë një rritje prej 2% në mbledhje, për shkak të rritjes së pritshme ekonomike prej 4% e cila mund të stimulojë transaksionet e pasurisë me 50% të rritjes reale ekonomike, pra 2%.

- Faktori i dytë ndikues është potenciali i përmirësuar i mbledhjes taksave. Ne kemi përmirësuar administrimin e taksave në mënyrë të qëndrueshme gjatë viteve të fundit dhe po ndërtojmë një databazë të saktë, duke kërkuar të vendosim një sistem faturimi. Supozojmë që këto përpjekje do të ecin përpara vitin e ardhshëm dhe ne do të rrisim mbledhjen e taksave me 10% në t+1 dhe 5% në t+2 dhe t+3.

- Për vitin t+2, qeveria është angazhuarta ndryshojë nivelin e taksës me 20% brenda vitit t+1.

Nëse një taksë rresht së ekzistuar në vitin t+1, përdor faktorin – 100% nën ndryshimin e nivelit të taksës.

Rezultati i përlogaritjes së çdo take (d.m.th. i grumbullimit të pritshëm vjetor) gjendet në kutitë në ngjyrë gri në anën e djathtë të formularit.

Përtë gjitha taksat e tjera të mbetura, procedura e parashikimit mbetet e njëjta.

3.15. Përlogaritja e burimeve: Taksat e ndara (E1)

Në teori të njëjtët tregues të përdorur për të përlogaritur modelet e grumbullimit të taksave të veta duhet të zbatohen edhe për taksat e përbashkëta. Por ka shumë të ngjarë që inputet për grumbullimin e pritshëm të taksave të përbashkëta të transmetohen drejtpërdrejt nga Ministria e Financës. Në këtë rast, ju thjesht duhet fusni përqindjen e rritjes në kolonën e ndikimit të përlogaritur të faktorëve të tjerë.

Në mënyrë alternative, ju mund të këshilloheni me draftin e buxhetit qendror, për të parë si janë përlogaritjet për taksat kombëtare dhe të përbashkëta. Për të llogaritur përafërsisht se çfarë do të marrë bashkia juaj, mund të përdorni trendin e mbledhjes kombëtare të taksave/ ponderuar me pjesën që ka marrë historikisht bashkia juaj. Plotësojeni edhe këtë informacion nën ndikimin e përlogaritur të faktorëve të tjerë.

Figura 14: E1 – Taksat e ndara

TË ARDHURA NGA TAKSAT E NDARA (GRANTE)	-	-	-
Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë / pasuritë e paluajtshme	-	-	-
Taksa vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorura	-	-	-
Taksa e rentës minerare	-	-	-
Taksa mbi të ardhurat personale	-	-	-
Taksa të tjera	-	-	-

3.16. Përlllogaritja e burimeve: E1: Tarifat

Fleta E1 përdoret për përlllogaritjen e të gjitha klasave të tarifave. Seksioni për tarifrat është ndërtuar në mënyrë të ngjashme me seksionin për përlllogaritjen e taksave. Ajo që është shpjeguar atje është e zbatueshme edhe këtu. Sidoqoftë, faktorët influencues nuk janë të njëjtët.

Për tarifrat, IPF merr parasysh pesë faktorë më impakt potencial: (1) përdorimi i përmirësuar i potencialit nga tarifrat; (2) rregullime ligjore; (3) rritja e volumit të aktivitetit; (4) rritja e tarifës për njësi; (5) të tjera.

Një ekstrakt i formularit E1/seksioni i tarifave është paraqitur në Figurën 15. Tarifa e pastrimit është përdorur si shembull për një taksë që ekziston tashmë për bizneset, por që është futur rishtaz për familjet. Do të bëhen përpjekje për shfrytëzimin më të mire të potencialit nga tarifrat duke përmirësuar mbledhjen e tarifave. Për më tepër, planifikohet të zgjerohet fusha e shërbimit; çka gjithashtu do të gjenerojë tarifa shtesë.

Figura 15: E1 - Tarifat

TË ARDHURA NGA TARIFA VENDORE	-	-	-
Tarifa me menaxhimit te mbetjeve	-	-	-
Tarifa e pastrimit për familjet	-	-	-
Tarifa e pastrimit për institucionet	-	-	-
Tarifa e pastrimit për biznesin	-	-	-
Tarifa për mbledhjen dhe largimin e mbetjeve	-	-	-
Tarifa për ndriçimin publik	-	-	-
Tarifa për ndriçimin publik nga familjet	-	-	-
Tarifa për ndriçimin publik nga institucionet	-	-	-
Tarifa për ndriçimin publik nga biznesi	-	-	-
Tarifa për gjelbërimin	-	-	-

3.17. Përlllogaritja e burimeve: Të ardhura jotatimore (E1)

Përlllogaritja për të ardhurat jotatimore ndjek teknikisht të njëjtën logjikë si taksat dhe tarifrat. Por ka shumë të ngjarë që faktorët ndikues të jenë mjaft më të kufizuar sesa në rastin e taksave.

Figura 16 tregon një shembull llogaritjeje për të ardhurat nga qiraja nga asetet, nga ndërmarrjet në pronësi të NjQV dhe shitja e të mirave dhe shërbimeve. Këto vlerësime duhet të bazohen në përvojat e viteve të kaluara dhe vlerësime teknike; hyrja e drejtpërdrejtë e vlerësimit është mundësuar. Në mënyrë të ngjashme, të ardhurat nga buxheti qendror dhe të mbarturat nga vitet e kaluara përfshihen në seksionin C dhe D të formularit E1.

Figura 16: E1 - Të tjera

TË ARDHURAT E TJERA	-	-	-
Qeraja nga asetet në pronësi të bashkisë	-	-	-
Kthimi nga investimet kapitale	-	-	-
Fitimi nga ndërmarrjet publike në varësi të Bashkisë	-	-	-
Kthimi nga partneriteti publik privat	-	-	-
Tërheqje e të ardhura krijuar nga shërbimet	-	-	-
Shitja e mallrave dhe shërbimeve	-	-	-
Kundravajtjet administrative (Gjobat)	-	-	-
Sekuestrime dhe Zhdëmtime	-	-	-
Kuotat e anëtarësisë së bashkive	-	-	-
Trasferata dhe ndihma nga njësitë e tjera vendore	-	-	-
Grante nga ndihma ndërkombëtare	-	-	-
Shitja e aseteve financiare	-	-	-
Shitja e aseteve fikse të prekshme / paprekshme	-	-	-
Të tjera	-	-	-

3.18. Përlllogaritja e të ardhurave nga buxheti i shtetit (transfertat) dhe huatë (E1)

Përt'u plotësuar nga: Departamenti i Buxhetit/Financës

Është i nevojshëm informacion paraprak për të specifikuar flukset e ndryshme nga transfertat e kushtëzuara, kontributet e donatorëve, huatë. Informacioni përkatës për transfertat për tre vitet e ardhshme jepet çdo vit nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Ky seksion është përpunuar nga Departamenti i Buxhetit/Financës. Gjithsesi rekomandohet fuqimisht që ky departament të këshillohet me departamentet e tjera lidhur me përlllogaritjen e transfertave të kushtëzuara dhe kontributet e donatorëve.

Figura 17: E1 - Përlllogaritja e të ardhurave nga buxheti i shtetit

TË ARDHURA NGA BUXHETI QENDROR	-	-	-
Transferta e pakushtëzuar	-	-	-
Transferta e kushtëzuar	-	-	-
Për funksionet e deleguara	-	-	-
Për projekte të veçanta (FZHR dhe të tjera)	-	-	-

3.19. Formularët e kërkesës buxhetore FKB (FKB1 - FKB27)

Përt'u plotësuar nga: Departamenti i Buxhetit/Financës

Formularët e kërkesës buxhetore FKB përdoren nga departamentet për të përgatitur kërkesat e tyre buxhetore brenda tavaneve të përcaktuara nga kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe të miratuara nga këshilli vendor. Ky proces do të sigurojë njësisë që sipas politikave të vendosura nga nivelet drejtuese të organizohen kërkesat buxhetore që vijnë nga nivelet bazë të njësisë vendore rekomandohet fort që departamentet të kenë përgjegjësi në procesin e hartimit të FKB-ve, sipas prioriteteve dhe kërkesve që ata kanë. Kështu do të zhvillohet një proces këshillimi brenda departamenteve dhe do të përfshiheshin të gjitha palët e interesuara në procesin transparent të buxhetimit. Kjo procedurë garanton që të respektohen plotësisht kërkesat që vijnë nga publiku, duke u bërë në këtë mënyrë një buxhet më realist dhe në ndihmë të interesit publik.

Është themelore që departamenteve t'u jepet kohë e mjaftueshme për të përgatitur kërkesat e tyre buxhetore. Sipas standardeve ndërkombëtare, një kuadër kohor prej të paktën 4 javësh do të ishte ideal. Ky kuadër kohor duhet të përfshihet në kalendarin e buxhetit të NjQV-ve.

Në përputhje me klasifikimin funksional të programeve buxhetore, ka gjithsej 27 FKB; për secilin program përdoret një FKB e veçantë. Për të gjurmuar informacionin, aktivitetet janë kufizuar në maksimumi katër për çdo FKB, siç është përcaktuar në formularin B3 të strukturës funksionale.

FKB përbëhet nga katër hapësira (shih Figurën 18):

- (1) Titulli (rreshti 2 deri 8);
- (2) Kuadri i kërkesës buxhetore (rreshti 14 deri 48) – vetëm rreshta output;

- (3) Përputhja me tavanet (rreshti 50 deri 63);
- (4) Buxhetet e detajuara për çdo aktivitet/projekt (rreshti 66 deri në fund të faqes). Lutemi, vini re që Figura 13 nuk e tregon këtë hapësirë për aktivitetin e dytë dhe të tretë! Paraqitet vetëm formati për aktivitetin e parë.

- (1) Titulli I formularit: Tabelë vetëm output.

Hapësira e titullit paraqet informacionin e përgjithshëm të programit. Në rreshtin 2, gjeni emrin e programit, departamentin përgjegjës të linjës, emrin përkatës të programit. Në rreshtat 3 deri 7, tregohen aktivitetet/projektet e këtij programi dhe karakterizohen natyra dhe lloji i tyre. I gjithë ky informacion futet automatikisht në FKB nëpërmjet fletës B3. Në këtë hapësirë nuk duhet bërë asgjë në mënyrë manuale.

- (2) Kuadri i kërkesës buxhetore

Hapësira e kuadrit paraqet shpenzimet e përgjithshme për programin:

Seksioni majtas (kolonat A deri në G) paraqesin një kuadër të shpenzimeve të përgjithshme për programin (pra shpenzimet bruto) Një ndarje e shpenzimeve bruto është paraqitur në përputhje me klasifikimin ekonomik në tri kategori kryesore: paga, shpenzime për mallra dhe shërbime të blera (konsum jo për paga) dhe investime kapitale.

Pjesa e sipërme e seksionit në të djathtë paraqet të ardhurat e mbartura nga programi (I15: 029), që mund ta kenë burimin tek tarifat e shërbimit kushtuar programit; ose transfertave të kushtëzuara (specifike, me destinacion) të mbartura.

Në pjesën fundore të seksionit, djathtas, (I32: 048) paraqitet një kuadër i kërkesës buxhetore për këtë program nga buxheti i përgjithshëm i bashkisë – d.m.th. shpenzimet për programin. Shpenzimet neto buxhetore janë llogaritur si diferencë midis shpenzimeve bruto (nevojat e përgjithshme për shpenzime) dhe të ardhurat totale nga programi (nga tarifat dhe të ardhurat e mbartura).

Sugjerim: Lutemi të vihet re që jo të gjitha programet buxhetore do të kenë të ardhura/të hyra neto të mbartura. Përgjithësisht kjo do të ndodhë në ato programme ku janë vendosur tarifa shërbimi (për shembull, pastrimi); ose kur merren grante të mbartura. Për shumicën e programeve buxhetore shpenzimet bruto dhe neto do të jenë të barabarta dhe këto do të financohen nëpërmjet buxhetit shumëfunksional të bashkisë.

Kjo hapësirë përllogaritet automatikisht. Informacioni në fushat portokalli vjen nga informacioni i mbledhur nga Departamenti I Buxhetit/Financës; shifrat në fushat a argjenta janë llogaritur mbi bazën e informacionit në hapësirën 4 të FKB. Në këtë hapësirë asgjë nuk duhet bërë në mënyrë manual.

- (3) Përputhja me tavanet

Ky seksion kontrollon nëse shpenzimet e përgjithshme për programin janë brenda tavanit të miratuar nga këshilli bashkiak.

1. Të dhënat janë llogaritur automatikisht nga informacioni i detajuar i futur në seksionet e shpenzimeve për aktivitetet të FKB; krahasuar me tavanet sikurse janë përfshirë në fletën D1 (Tavanet).

Fleta krahason tavanin e përgjithshëm për programet me shpenzimet e përgjithshme, si dhe kategoritë ekonomike të shpenzimit me tavanet përkatëse të pagave, me shpenzimet e tjera operacionale dhe shpenzimet kapitale.

Të dhënat llogariten automatikisht. Bazuar në këtë, kolona L do të krijojë "OK!", nëse shpenzimet janë në linjë me tavanet.

Në rastin kur shpenzimi i parashikuar e ka tejkaluar tavanin e dhënë, në kolonën L do të shfaqet shenja "STOP!" Zyrtarët do të duhet të rishikojnë premiset e shpenzimit në nivelin e aktivitetit, për të siguruar përputhjen.

(4) Buxheti i detajuar për çdo program/projekt

Sikurse është thënë, çdo FKB lë hapësirë vetëm për një numër të kufizuar programesh. Në rreshtin e titullit, që është nënvizuar me ngjyrë të bruztë (#66, #104 dhe #142), informacioni futet automatikisht informacioni i mëposhtëm: kodi i programit, emri i programeve për çdo funksion dhe nënfunksion.

Poshtë rreshtit të titullit, gjeni tri nënhapësira:

- (I) Ana e majtë i kushtohet për llogaritjes së shpenzimeve,
- (ii) Ana e djathtë për për llogaritjen e të ardhurave,
- (iii) Dhe poshtë (rreshti 95 deri 101), është lënë vend për shpjegim.

Figura 18: FKB1 deri FKB27 – Formulari i kërkesës buxhetore

Numër	Emri i Nënfunksionit					
Nënfunksioni 1	011 Organet ekzekutive dhe legjislative, për çështjet financiare dhe fiskale, çështjet e brendshme					
Drejtoria / Departamenti	Kryetari i programit					
	Emri i programit	Programi: detyrueshme / shtesë			Programi: I veti / I deleguar / Transferuar	
Programi 1a	Planifikimi Menaxhimi dhe Administrimi	E detyrueshme			I veti	
Programi 1b	Çështje financiare dhe fiskale	E detyrueshme			I veti	
Programi 1c	Sherbime të përgjithshme publike	E detyrueshme			I veti	
Programi 1d	Gjendja civile	E detyrueshme			I deleguar	
Programi 1e	0	0			0	
Programi 1f	0	0			0	
PËRMBLEDHJE E KËRKESËS BUXHETORE						
Nënfunksioni 1	011 Organet ekzekutive dhe legjislative, për çështjet financiare dhe fiskale, çështjet e brendshme					
SHPENZIME TË PRITSHME				TË ARDHURAT E PRITSHME		
	-2	-1	0	1	2	3
SHPENZIME TË PRITSHME	0	0	0	0	0	0
VLERËSIM I ARDHURAVE NGA TARIFAT						
VLERËSIM I ARDHURAVE NGA TARIFAT	0	0	0	0	0	0
VLERËSIMI I TË ARDHURAVE ME DESTINACION						
Transferata e kushtëzuar				0	0	0
Transferata Specifike				0	0	0
Trashëgimi me destinacion				0	0	0
Burime të tjera (përfshirë gjrobat)				0	0	0
VLERËSIMI I TË ARDHURAVE ME DESTINACION	0	0	0	0	0	0
TË ARDHURAT E PRITSHME	0	0	0	0	0	0
SHUMA E KËRKUAR NETO						
SHUMA E KËRKUAR NETO	-	-	-	-	-	-
Angazhimet	Vlera Totale për Aktivitet			0	0	0
Qëllime	Shpenzimet kapitale			0	0	0
	Mallra dhe shërbime			0	0	0
	Qëllime të mëtejshme			0	0	0
				OK	OK	OK

Le të shohim tani më nga afër nënhapsirën (i) përlogaritje shpenzimesh dhe (ii) përlogaritje të ardhurash për çdo aktivitet.

(i) Shpenzimet sipas formularit të kërkesës së buxhetit

Nënhapsira për përlogaritje shpenzimesh është ndarë sërish në tri seksione (shiko Figurën 19): Pjesa e sipërme (rreshti 72) përdoret për të përlogaritur shpenzimet bruto për një program; seksioni i lart (rreshtat 76 deri 86) i kushtohet një përlogaritjeje të ndarë të kostove direkte të projekteve më të mëdha, si investimet kapitale; së fundi, seksioni më poshtë, (rreshtat 89 deri 99) përdoret për përlogaritjen e ndarë të kostove periodike të aktivitetit të financuar nga buxheti.

Figura 19: Përlogaritja e shpenzimeve për program/projekt

66	Nënfunkcioni 10	051 Menaxhimi i i mbetjeve					
67	Programi 10a	Menaxhimi i mbetjeve					
68	05100						
69	SHPENZIME TË PRITSHME						
70		-2	-1	0	1	2	3
71							
72	SHPENZIME TË PRITSHME	0	0	0			
73							
74	SHPENZIME TË PRITSHME						
75	KOSTO DIREKTE PËR PROJEKTET DHE SHPENZIMET KAPITALE						
76	Pagat	600					
77	Sigurimet Shoqërore	601					
78	Mallra dhe shërbime	602					
79	Subvencione	603					
80	Të tjera transferta korrente të brendshme	604					
81	Transferta korrente të huaja	605					
82	Transferta për Buxhetet Familjare dhe Individët	606					
83	Shpenzimet kapitale	230 / 231					
84	Rezerva	609					
85	Interesa per kredi direkte ose bono	650					
86	Të tjera	69 / ?					
87	KOSTO DIREKTE PËR PROJEKTET	0			0	0	0
88	SHPENZIME KORRENTE						
89	Pagat	600					
90	Sigurimet Shoqërore	601					
91	Mallra dhe shërbime	602					
92	Subvencione	603					
93	Të tjera transferta korrente të brendshme	604					
94	Transferta korrente të huaja	605					
95	Transferta për Buxhetet Familjare dhe Individët	606					
96							
97	Rezerva	609					
98	Interesa per kredi direkte ose bono	650					
99	Të tjera	69 / ?		OK!	0	0	0
100	SHPENZIME KORRENTE				0	0	0
101							
102	SHPENZIME TË PRITSHME	0	0	0	0	0	0

- Shpenzimi i pritshëm: (Radha 72)

Shuma totale e shpenzimit të planifikuar për aktivitetet duhet të plotësohet në këtë seksion. Të dhënat nga buxheti i vitit të kaluar dhe në vazhdim do të importohen automatikisht nga informacioni i ngarkuar më parë.

- Kostot direkte për projektet dhe shpenzimet kapitale vs. kostove të përsëritura (korrente):

Tani le të kalojmë te dy sektorë shtesë të pjesës së shpenzimeve, që u kushtohen kostove direkte të projekteve dhe investimeve kapitale, nga njëra anë, dhe kostove të përsëritura, nga ana tjetër. Lutemi mbani parasysh që, po të harroni të plotësoni këtë hapësirë, do të keni probleme me tavanet. Veç kësaj, IPF do t'i përfshijë shpenzimet e pushpëguara në kategorinë "Të tjera" në rreshtin 99, që përdoret si qelizë kontroll. Krahas kësaj, informacioni nga dy seksionet e informacionit për kostot përdoret edhe për tabelat output. Kur nuk i plotësoni si duhet këto hapësira, detajet e planit financiar të bashkuar do të paraqitet në mënyrë të pasaktë dhe jo të gjitha tabelat e rezultateve mund të përdoren.

(ii) Seksioni mbi të ardhurat i formularit të kërkesës buxhetore

Tek seksioni mbi të ardhurave në formularin e kërkesës buxhetore vlerësohen dy klasa të ardhurash: tarifat dhe transfertat e mbartura. Të dyja klasat mund të lidhen drejtpërdrejt me aktivitetin/projektin që shqyrtohet. Nën titullin e gjelbër, shuma neto e kërkuar rezulton si mbetje e shpenzimeve të pritshme për këtë aktivitet (ana e majtë e FKB, rreshti 102) dhe të ardhurave të pritshme në formën e tarifave dhe të ardhurave të mbartura (shih. Figurën 20).

Figura 20: Përlogaritja e të ardhurave brenda formularit të kërkesës buxhetore

69	TË ARDHURAT E PRITSHME						
70		-2	-1	0	1	2	3
71							
72	VLERËSIM I ARDHURAVE NGA TARIFAT						
73	VLERËSIM I ARDHURAVE NGA TARIFAT	0	0	0			
74							
75	VLERËSIM I TË ARDHURAVE ME DESTINACION						
76	Transferta e kushtëzuar						
77	Transferta Specifike						
78	Trashëgimi me destinacion			0			
79	Burime të tjera (përfshirë gjobat)						
80	VLERËSIM I TË ARDHURAVE ME DESTINACION	0	0	0	0	0	0
81							
82	TË ARDHURAT E PRITSHME	0	0	0	0	0	0
83							
84							
85							
86	SHUMA E KËRKUAR NETO						
87	SHUMA E KËRKUAR NETO	-	-	-	-	-	-
88							
89							
90							
91	Angazhimet	Vlera Totale për Aktivitet		0	0	0	
92	Qëllime	Shpenzimet kapitale					
93		Mallra dhe shërbime					
94		Qëllime të mëtejshme					
95				OK	OK	OK	
96	Shpjegimet teknike						
97	1						
98							
99	2						
100							
101	3						
102							

Le t'i hedhim një sy tani përlogaritjes së të ardhurave nga tarifat dhe të ardhurave të mbartura.

Në seksionin e të ardhurave të pritshme, në tarifat, të dhënat për mbledhjet e viteve të mëparshme (d.m.th. kontributet për programet) plotësohen automatikisht. Plotësoni vëllimin e pritshëm të të ardhurave për periudhën buxhetore. Lutemi vini re që të dhënat në këtë seksion janë identike me të dhënat e plotësuara në fletën "Përlogaritja e të ardhurave".

Përlogaritja e transfertave të mbartura bazohet plotësisht në informacionin e NjQV-së dhe të departamenteve të saj. I gjithë informacioni i disponueshëm do të përdoret nga ekspertët, për parashikuar në mënyrë realiste se ç'mund të pritët. Zyrtarët duhet të plotësojnë të dhënat për a) grantet e kushtëzuara për programin/aktivitetin; kontribute të tjera (d.m.th. donacione); burime të tjera (d.m.th. gjoba). Të dhënat për të mbarturat në destinacion do të ngarkohen automatikisht, të importuara nga fletët përkatëse.

Totali i të dyja burimeve të të ardhurave, tarifave dhe transfertave të mbartura, mblidhen dhe rezultati del në kutitë djathtas "Të ardhurave të pritshme".

Është themelore për departamentet e linjës që të kenë një pamje të qartë për çka mund të presin nga përdoruesit në kuadrin e tarifave dhe nga palë të treat në formën e transferatve të mbartura. Sa më e lartë kjo e ardhur direkte, e lidhur me aktivitetin, aq më e ulët do të jetë shuma neto e kërkuar. Lutemi të jeni të vetëdijshëm për marrëdhënien e mëposhtme: kur një aktivitet e caktuar zvogëlohet, atëherë shpresohet që të zvogëlohen edhe shpenzimet për këtë aktivitet. Por në shumë raste do të pakësohen edhe tarifat, si dhe të ardhurat e mbartura. Prandaj, nëse zvogëloni një aktivitet, të themi 20%, atëherë shpenzimet mund të zbersin ndoshta 5% (jo 20% për shkak të kostove fikse). Veç kësaj, kur zbret e ardhura e lidhur drejtpërdrejt me aktivitetin, kursimet në kuadrin e kërkesës neto të buxhetit janë shumë më të ulëta se 20%, ndoshta 10%, në vartësi të rëndësisë dhe raportit me këto të ardhura të drejtpërdrejta të lidhura me aktivitetin.

Zyrtarët në njqvv dhe institucionet e varësisë duhet të jenë të ndërgjegjshëm për rëndësinë dhe potencialin e të ardhurave me destinacion, të lidhura me veprimtaritë (si për shembull tarifat). Sa më të larta të jenë këto të ardhurat, për shembull tarifa e pastrimit për shërbimin e menaxhimit të mbetjeve, aq më shumë mbulohen kostot dhe më pak ngarkohet buxheti i bashkisë nga të ardhurat me qëllim të përgjithshëm (si taksat dhe transfertat e tjera). Këto kursime forcojnë potencialin e NjQV dhe përmirësojnë më tej shërbimet publike dhe e bëjnë më tërheqëse NjQV.

Zyrtarët e buxhetit në departamentet e linjës dhe të Departamentit të Financës duhet të mblidhen së bashku dhe të sigurohen që përlogaritjet e departamenteve të linjës për të ardhurat e lidhura drejtpërdrejt me aktivitetet janë në përputhje me përlogaritjet e Departamentit të Financës për tarifat dhe të ardhurat e mbartura. FKB e IPF ndihmon që këto përlogaritje të departamenteve të ndryshme të NjQV të bëhen transparente dhe të krahasueshme; kjo është baza për të arritur koherencë në planifikimin financiar.

4. Të dhënat output dhe interpretimi i tyre (F1 - F16)

IPF prodhon dy klasa rezultatesh, tabela dhe grafikë. Skedat e fletëve për tabela janë të nënvizuara me të gjelbër të errët; për grafikët – në të gjelbërtë lehtë.

Gjithsej, IPF prodhon 9 tabela dhe 8 grafikë, që mund të përdoren drejtpërdrejt për qëllime komunikimi. PBA jep sugjerime se cili informacion i IPF në cilin seksion të PBA mund të përdoret. Megjithatë kini kujdes në paraqitjen e këtyre tabelave dhe grafikëve për shkak se është i rëndësishëm përfshirja e tyre në projektbuxhetin afatmesëm. Këto tabela janë të ndërtuara në mënyrë të thjeshtëzuar me qëllim përfshirjen e një audience sa më të gjërë. Informacioni përcjellë në këtë mënyrë, duhet të jetë i thjeshtëzuar dhe i kuptueshëm qartë me qëllim që të përfshihet një audiencë sa më e gjërë qytetarësh dhe grupe interesi. Përzgjidhni grafikët dhe tabelat që ju duken të rëndësishme. Nënazoni në një koment se ç'është e rëndësishme të shihet dhe të dihet nga secili grafik apo tabelë që ju përzgjidhni për ta paraqitur.

IPF paraqet kuadrin e burimeve buxhetore në tabelën F1. Shpenzimet janë paraqitur në mënyra të ndryshme:

- Sipas klasifikimit të programeve (F2 deri F5);
- Sipas klasifikimit të sektorëve (F6 & F7);
- Sipas llojit të aktivitetit, d.m.th. e detyrueshme/shtesë ose e vetja/e deleguar/e transferuar rishtas (F8& F9);
- Sipas klasifikimit ekonomik (F10&F11);
- Zëra shpenzimesh specifike, si më poshtë:
- Të prapambetura në fund të viti (F12);
- Grafik i investimeve kapitale (F15).

IPF i paraqet rezultatet e bashkuara me shifra bruto dhe neto. Shifrat bruto informojnë grupet e interesit për sasinë e përgjithshme të shpenzimeve të planifikuara sipas klasifikimit ekonomik dhe programor. Shifrat neto tregojnë sa duhet paguar me paratë e taksave vendore dhe grantet me qëllim të përgjithshëm për mbulimin e shpenzimeve sipas programeve buxhetore.

Veç kësaj, IPF paraqet një përmbledhje të burimeve të përgjithshme buxhetore (F13), pra, burimet totale buxhetore, shpenzimet totale dhe tepricën e plotë ose tejkalimin e shpenzimeve.

Së fundi, në fletën F14, the IPF llogarit për 9 tregues financiarë (shih) raportet në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 68, datë 27.04.2018 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”. Këta tregues duhet të përdoren për të vlerësuar nëse plani afatmesëm financiar ka një shpërndarje pozitive në vite dhe parashikon rritje të treguesve që ndikojnë në përmirësimin e ekonomisë së njësisë. Për interpretimin dhe vlerësimin e vlerave të treguesve, kërkohet një strategji financiare e NjQV me objektiva të qartë vlerash. Kjo strategji mund të jetë pjesë e PZhS; megjithatë një strategji e veçantë sektoriale mund të jetë më e përshtatshme, sepse kjo qasje ofron më shumë fleksibilitet.

Tabela 2 : Tregues financiarë

Treguesi	Interpretimi i mundshëm
Shpenzimet e përgjithshme/burimet e përgjithshme buxhetore	Nëse shpenzimet e përgjithshme janë më të larta se burimet e përgjithshme buxhetore, NjQV krijon deficit veprim financiar i cili është i ndaluar me ligj.
Të ardhura nga taksa dhe tarifa/ burimet e përgjithshme buxhetore	Sa më i madh është ky raport, aq më e madhe është pavarësia vendore, nga njëra anë, por, nga ana tjetër, aq më e madhe është barra e taksave. Ekziston një kompromis midis dy problemeve të pavarësisë dhe barrës së ulët të taksave për qytetarët e NJVQV-së. Në rastin e tarifave, që lidhen më dhënieve e shërbimeve, qytetarët me të ardhura të ulëta e kanë më të vështirë të paguajnë tarifa.
Të ardhura të vetat/burimet e përgjithshme buxhetore	Tregues për pavarësinë dhe forcën fiskale të NjQV.
Investime kapitale/Shpenzimet e përgjithshme	Tregues për orientimin e zhvillimit të financave të NjVQV.
Shpenzime personeli/Shpenzimet e përgjithshme	Tregues i efektshmërisë së administratës vendore
Hua afatgjata/burimet e përgjithshme buxhetore	Tregues i varësisë financiare të NjQV
Hua afatgjata/ Të ardhura të vetat	Tregues i vartësisë financiare të NjQV

Korrektesa e tabelave dhe grafikëve të outputeve varet nga saktësia dhe karakteri i plotë i futjes së të dhënave në hapësirën e inputeve të IPF.

5. Lista e termave teknikë dhe shkurtimeve

<i>Termi</i>	<i>Përkufizimi</i>
Aktiviteti	Proces në vazhdim që kryhet për të arritur një objektiv politikash
FKB	Formulari i Kërkesës Buxhetore, përdoret nga departamentet e linjës për të përgatitur një projektbuxhet për çdo program dhe veprimtari në fushën e përgjegjësisë së tyre
Tavanet	Kufiri maksimal (apo minimal) i lejuar të shpenzohet për një zë të caktuar. IPF jep tavanet e mëposhtme: <ul style="list-style-type: none"> - Tavani përgjithshëm për program (maksimumi i lejuar) - Tavani i pagave dhe sigurimeve shoqërore për program (maksimumi i lejuar) - Tavani i konsumit për program (blerje mallrash dhe shërbimesh) - Minimumi i kërkuar i investimeve kapitale
Kosto direkte projekti	Kostot për përgatitjen dhe zbatimin e projektit, duke përfshirë menaxhimin e projektit. Shih edhe: Kosto periodike.
dldp	Programi për Zhvillim Lokal dhe Decentralizim
Tregues financiar	Shifra kyce financiare që përdoren për të vlerësuar qëndrueshmërinë e financave vendore në mënyrë agregate.
IPF	Instrumenti i Planifikimit Financiar
Shpenzime bruto	Shpenzimet e përgjithshme, duke përfshirë ato që mbulohen nga palë të treat (tarifa përdorimi, grante të qeverisë qendrore, kontribute donatorësh etj.). Shih edhe: Shpenzime neto
HSLU	Universiteti i Shkencave të Aplikuara dhe Arteve Lucerne
ISB	Instituti i Studimeve Bashkëkohore, Tiranë

Parashikime	Parashikime planifikuese për zhvillimin ekonomik që prekin financat e NjQV-ve gjatë periudhës së planifikimit afatmesëm: rritja ekonomike, inflacioni, niveli interesave në afate të shkurtëra e të mesme, rritja e pagave
Afat i mesëm	Tre vitet e ardhshme
PBA	Programi i Buxhetit Afatmesëm
MoFE	Ministria e Financës dhe Ekonomisë
n.e.c.	E paklasifikuar gjatë
Shpenzime neto	Shpenzimet e përgjithshme, duke përjashtuar çka mbulohet nga palë të tret (nëpërmjet tarifave të përdorimit, granteve të qeverisë qendrore, kontributeve të donatorëve etj.). Shih edhe: Shpenzime bruto.
Program	Fushë e politikave që kombinon detyra që pajtohen (të një NjQV). Programet përbëhen nga një ose më shumë aktivitete; ato drejtohen nga të njëjtat qëllime dhe objektiva politikë.
Kosto periodike	Kosto në vazhdim si efekt i aktiviteteve në vazhdim ose një strukture të re. Shembull: Kur ndërtohet një qendër shëndetësore, kjo kërkon staf, barna, ngrohje etj. Gjatë të gjitha viteve të mëvonshme. Shih edhe: Kosto direkte projekti
SDC	Swiss Agency for Development Cooperation
Ndryshim strukturor	Zhvillim demografik, ligje të reja ose rregullime ligjore, procedura të reja etj. Që mund të ndikojnë mbi shpenzimet e programeve.
Të prapambetura	Pagesa që janë vonuar më shumë se 90 ditë kalendarike.
Të mbartura në destinacion	Fonde që kanë qenë premtuar dhe nuk janë dhënë deri në fund të vitit buxhetor. Këto fonde zakonisht duhet të rivendosen me të njëjtin qëllim në vitin tjetër buxhetor, përveç se kur angazhimi (subjekti) nuk ekziston më.
Angazhim	Angazhim buxhetor për detyrime financiare i marrë në formë të shkruar, përmes pjesëmarrjes në një marrëveshje kontraktuale.



Publikuar nga Programi për Zhvillim Lokal dhe Decentralizim (dl dp),
financuar nga Qeveria Zvicerane përmes Agjencisë Zvicerane për Zhvillim
dhe Bashkëpunim (SDC), zbatuar nga Helvetas Swiss Intercooperation



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC

